



Prishtinë, 14 prill 2011
Kodi i ZRRE-së: V_360_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e dhëna në Nenin 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenin 41 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Raportin Konsultativ lidhur me kushtet e tregut të furnizimit me energji elektrike për vitin 2011
- Vendimin e Bordit të ZRRE-se të datës 30 mars 2011 lidhur me kriteret e matjes së konkurrencës

Në seancën e mbajtur me datë 14 prill 2011, nxori këtë:

VENDIM

Mbi ekzistimin e Konkurrencës Efektive në Tregun e Energjisë

- I. Sipas kriterëve të përcaktuar në Vendimin e ZRRE-së V_342_2011, nuk ekziston konkurrencë efektive.
- II. Si pasojë e mungesës së konkurrencës efektive, furnizimi me energji elektrike në tregjet relevante të Vendimit të ZRRE-së V_342_2011 duhet të bëhet me tarifë të rregulluar.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar